

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-Departamenti për Çështje Ekonomike, me gjyqtaren Franciska Zhitia-Ymeri, duke vendosur lidhur me çështjen juridike të paditëses Kompania e Sigurimeve “E.” me seli në P., të cilën sipas autorizimit e përfaqëson V. B. jurist nga P., kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “S.” me seli në P., të cilën sipas autorizimit e përfaqëson L. B. jurist nga P., me objekt kontesti kompensim i dëmit-regresit në vlerë prej 2,021.00 euro, pas përfundimit të seancës publike të shqyrtimit kryesor të datës 11.12.2017 dhe pas marrjes së fjalës përfundimtare nga e paditura, ndërsa me datë 20.12.2017, merr këtë:

A K T G J Y K I M

I. REFUZOHET në tërësi si e pabazuar kërkesëpadija e paditëses Kompania e Sigurimeve “E.” me seli në P. e paraqitur kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “S.” me seli në P., ashtu që të obligohet e paditura që në emër të kompensimit të dëmit-regresit të paguajë shumën e përgjithshme prej 2,021.00 euro (dy mijë e njëzetë e një euro), me kamatë ligjore duke filluar nga data 27.12.2016 si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore të gjitha këto në afat prej 15 ditësh llogaritur nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcenim të përmbarimit me dhunë.

II. Secila palë i bartë shpenzimet e procedurës kontestimore veç e veç.

A r s y e t i m

Paditësja Kompania e Sigurimeve “E.” me seli në P., ka parashtruar padi me datë 04.01.2017, kundër të paditurës Kompania e sigurimeve “S. ”, me seli në P., duke kërkuar që të obligohet e paditura që në emër të kompensimit të dëmit-regresit të paguajë shumën e përgjithshme prej 2,021.00 euro, me kamatë ligjore duke filluar nga data 27.12.2016 dhe shpenzimet e procedurës kontestimore të gjitha këto në afat prej 15 ditësh llogaritur nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcenim të përmbarimit me dhunë.

I autorizuari i paditëses si në padi ashtu edhe në seancën kryesore ka theksuar se qëndron pranë padisë dhe kërkesëpadisë, duke ka shtuar se me datën 10.09.2012 ka ndodhur aksident trafiku ku ish-in përfshirë automjeti i udhëtarëve “VW Golf VI” me targa *numri i targave.....*, i siguruar te paditësja dhe automjeti Iveco Magirus, me targa *numri i targave.....*, kështu që deri te shkaktimi i aksidentit ka ardhur me përdorimin e automjetit të markës Iveco Magirus, kështu që vozitësi i këtij automjeti merr veprim të pasigurtë fillon të kalon në shiritin e djathtë të rrugës duke mos dhënë përparësi kalimi automjetit “VW Golf VI” të njëjtin e godet në anën e majtë duke shkaktuar aksident trafiku, i siguruar kasko te paditësja, po ashtu automjeti Iveco Magirus, me targa *numri i targave.....*, me përdorimin e të cilit është shkaktuar aksidenti në momentin e aksidentit ishte i pajisur me polic të vlefshme sigurimi sipas policës TPL, nr. 3846008 dhe ka kërkuar nga gjykata që kërkesëpadinë e saj ta aprovoi në tërësi si të bazuar.

Shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar.

I autorizuari i të paditurës në përgjigje në padi dhe shqyrtimin kryesor e ka kontestuar padinë dhe kërkesëpadinë e paditëses në tërësi për arsye se aksidenti ka ndodhur me datë 10.09.2012 ndërsa padia është paraqitur me datë 04.01.2017, andaj kanë kaluar më shumë se tri vite dhe kërkesëpadia e paditëses është parashkruar, andaj edhe ka propozuar që kërkesëpadia e paditëses të refuzohet si e pa bazuar për shkak se njëjta është e parashkruar.

Shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar.

Gjykata gjatë shqyrtimit kryesor të kësaj çështje juridike ka administruar këto prova si në vijim: kërkesa e paditësit e datës 20.11.2015, ndërsa e pranuar nga e paditura me datë 28.12.2015, raporti policer i datës 10.09.2012, policia për sigurimin kasko të automjeteve me nr.000822, procesverbali mbi dëmin pa datë, fotodokumentacionet me 12 shtojca, akt vlerësimi i demit i datës 10.10.2012, marrëveshja jashtë gjyqësore e datës 06.12.2012, urdhër pagesa e lëshuar nga T. Banka e datës 13.12.2012, fatura me nr.1997/12 C e datës 05.10.2012.

Pas shqyrtimit dhe analizës së këtyre provave dhe pretendimeve të dy palëve në procedurë Gjykata gjeti se kërkesëpadia e paditëses është e parashkruar dhe atë konform dispozitave të nenit 376 të LMD-së, prandaj edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata duke u bazuar në provat e administruara gjeti se nga data e aksidentit të komunikacionit datë 10.09.2012, e deri te paraqitja e padisë datë 04.01.2017, ku dhe ka vërtetuar faktin lidhur me kohën e afatshme për paraqitjen e kërkesës lidhur me përmbushjen e detyrimit sipas nenit 376 të LMD-së, kështu që nga data e shkaktimit të aksidentit datë 10.09.2012, e deri me datën 04.01.2017, si datë e paraqitjes së padisë kanë kaluar më shumë se 3 vite, andaj edhe është përmbush kushti ligjor për refuzimin e kërkesëpadisë si të pabazuar duke iu referuar dispozitave të nenit 376 të LMD-së, në të cilën është paraparë në mënyrë decitive se "*kërkesa e shpërblimit të demit të shkaktuar parashkruhet për tri vjet nga data kur i dëmtuari ka mësuar për dëmin dhe për personin që e ka bërë dëmin*".

Gjykata vlerësoj edhe pretendimin e të autorizuarit të paditëses se nuk mund të ketë parashkrim për shkak se e paditura e ka pranuar kërkesën nga pala paditëse me datë 28.12.2015, mirëpo gjykata këtë pretendim e konsideron si të pabazuar dhe atë duke u bazuar në dispozitivin e nenit 391 të LMD-së, në të cilin thuhet se "*Për ndërprerjen e parashkrimit nuk mjafton që kreditori ta ftojë debitorin me shkrim ose me gojë që ta përmbushë detyrimin*" kështu që afati i parashkrimit të kërkesëpadisë nuk është ndërprerë, andaj gjykata ka vendosur si në dispozitivin të këtij aktgjykimi.

Gjykata pas shtjellimit të çështjes juridike civile të paditësit lidhur me kompensimin e demit në vlerë prej 2,021,00 euro, nuk është lëshuar në administrimin e provave të tjera, për faktin se kur kemi të bëjmë me parashkrimin e kërkesës atëherë nuk mund të vlersohen provat tjera të cilat nuk mund të jenë valide në marrjen e një vendimi meritore.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës është marrë në bazë të nenit 450 të LPK-së, që secila palë ti bartë shpenzimet e veta procedurale veç e veç.

Nga të lartë cekurat kjo gjykatë ka vlerësuar se kërkesëpadia e paditëses është e pabazuar në bazë të nenit 376, 391 të LMD-së, si dhe nenit 143 të LPK-së, andaj dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
Departamenti për çështje ekonomike
III.EK.nr.4/17 me datë 20.12.2017

Gjyqtarja
Franciska Zhitia-Ymeri

KËSHILLË JURIDIKE: Ndaj këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afatin kohor prej 7 (shtatë) ditëve, duke llogaritur nga dita e pranimit të tij, duke iu drejtuar Gjykatës së Apelit në Prishtinë përmes kësaj gjykate.